

Data: 07.05.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI: “BLERJE GAZRA TË NDRYSHME MJEKËSORE PER “RIPRODHIMIN E ASISTUAR”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Gazra Mjekësore 24111500-0, Dioksid karboni 24112100-3, azot 24111700-2, azot i lëngët 24111800-3*

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,900,963.33 lekë (nëntë milion e nëntëqind mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë tidhjetë e tre) lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit*

të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet

operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera 39% e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë : c) 40 % vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme .”*

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 55 pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose*

entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 55 pika 4/b VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme çka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
 - ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
 - ISO 45001:2018, përditësuar (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent, (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
 - ISO 14001:2015 “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës) ose ekuivalent.

Shënim: Do të pranohet dhe SSH/EN/ISO (te përditësuar), sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit Shqiptar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i**

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme. AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa pro-aktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen aktivitetin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku. Për një furnitor, të jetë i certifikuar ISO 45001 tregon angazhimin ndaj sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve, që përkthehet në një reputacion më të mirë në treg dhe rrit besueshmërinë tek klientët.

3. Operatori Ekonomik duhet të ketë bombula në dispozicion/pronësi për gazet teknike dhe për këtë duhet të lëshojë një deklaratë dhe ti bashkangjisë faturat e blerjes ose kontratën e qirasë nëse i ka marr me qira këto bombula ose autorizim nga shoqëri që kanë bombula në pronësi (ti bashkangjisë faturat e blerjes ose deklarate doganore).

4. Operatori Ekonomik për produktet objekt prokurimi duhet të ketë certifikatë konformiteti për secilin nga gazet /ose autorizim nga shoqëri që kanë produktet objekt prokurimi (sebashku me certifikatën e konformitetit).

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e konformiteti për bombulat e gazit.

6. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me një vërtetim nga ISHTI të lëshuar jo më heret se 6 muaj nga data e hapjes së tenderit, që merret me aktivitetin e gazeve teknike objekt prokurimi dhe që ka bombula të regjistruara për gazet teknike /Ose Autorizim nga shoqëri që merren me këte aktivitet (sebashku me vërtetim nga ISHTI).

7. Çdo bombul duhet të jetë e pajisur me etiketën përkatëse ku të jenë të përshkruara gazet objekt prokurimi.

8. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin, vendosjen e mallrave objekt prokurimi dhe trajnimin e stafit, sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën 6 ”Formulari i Specifikimit teknike” në ambjentet e Autoritetit Kontraktor përfitues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuara bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, I ndryshuar,

ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr.6, datë.09.01.2015”Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr.315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Vendimit KM nr. 417, datë 25.6.2014 Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit Ligjit Nr.8450 Dt 24.02.1999 I ndryshuar, VKM Nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë transportin e mallrave objekt prokurimi ne adresen e Autoritetit Kontraktor Perfitues. Kjo i jep siguri Autoritetit Kontraktor Perfitues që operatori ekonomik do të realizojë me sukses kontratën.

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë bombula me gazet objekt prokurim që garanton kapacitetin real logjistik, siguron vazhdimësinë e furnizimit pa ndërprerje për realizimin e kontratës. Certifikata e konformitetit, garanton përputhshmërinë me standardet teknike dhe të sigurisë, sigurimin që bombulat janë të përshtatshme për përdorim me presion të lartë, garantimin e cilësisë së gazrave për përdorim laboratorik. Etiketimi i bombulave parandalon ngatërrimin e gazrave në ambiente laboratorike, garanton informim të qartë mbi rreziqet, përbërjen, specifikimet teknike e cila është e rëndësishme ne laborator ku kërkohet saktësi e lartë për përdorim të sigurt të gazrave nën presion.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi I specifikimeve teknike

Argumentimi: *Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik

ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) *Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

b) *Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

c) *Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike të paisjeve janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues **Spitali Universitar Obstretik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”** si mëposhtë:

Specifikimet Teknike të Gazrave, cilësia dhe standartet, si dhe sasia që duhet të furnizohemi për (12 muaj / 100 pacient).

Nr.	Emertimi	Specifika e furnizimit	Njesia	SASI Per 100 paciente IUI ,100 IVF,100 Embriotrasferta per 12 muaj
1	Gaz CO2	1 Bombul = 40kg CO2	Kg (1bombul =35kg -40kgCO2)	800
2	Gazi N2	1 Bombul =10 m ³ N2	m ³ (1 bombul=8 m ³ -10 m ³ N2)	300
3	Gazi miks 6% CO 2,5% O2 dhe 89% N2	1 Bombul =10 m ³ gaz miks 6%CO2,5%O2 dhe 89%N2	m ³ (1 bombul=8 m ³ -10 m ³ gaz miks 6%CO2,5%O2 dhe 89%N2)	260
4	Azot I lenget	Tanker = 60 Liter Azot i lenget	Liter (1 Tanker = 55-60 litra)	2100

Specifikimet teknike të furnizimit nga Operatori Ekonomik.

1. Cfarë duhet të siguroj operatori ekonomik për plotësimin e nevojave tona.

- Te sigurojë minimumi 4 Bombula (35-40 kg) për gaz CO₂. (2 bombula në linjë, 2 bombula rezervë që të mos ketë në asnjë moment ndërprerje të furnizimit).
- Te sigurojë minimumi 4 Bombula (8-10 m³) për gaz N₂. (2 bombula në linjë, 2 bombula rezervë që të mos ketë në asnjë moment ndërprerje të furnizimit).
- Te sigurojë minimumi 4 Bombula (8-10 m³) për gaz miks 6% CO; 2,5% O₂; dhe 89%N₂. (2 bombula në linjë, 2 bombula rezervë që të mos ketë në asnjë moment ndërprerje të furnizimit).
- Të sigurojë minimumi 2 Tanker (55-60 Liter) për Azot të lëngët. (1 Tanker vjen i furnizuar dhe meret Tankeri bosh dhe kur kerkohet furnizim të sillet në kohë, për të mos patur vonesa).
- Te sigurojë 1 Peshore elektronike për peshimin e bombulave, për nxjerrjen dhe konvertimin e njësisë matëse të gazërave në bombula ose në Tanker (cdo furnizim).
- Te sigurojë 1 Automjet të përshtatshëm për transport të bombulave me gazra.
- 1 Person për ngarkim-transport-shkarkim të bombulave me gazra mjeksorë.
- 1 Fletë analize të produktit e cila duhet të jetë me afat jo më shumë se 3-6 muaj(për çdo furnizim).
- Faturë shoqërimi të sasisë së gazrave.

2. Kushtet e furnizimit.

Operatori ekonomik duhet të garantojë furnizim të pandërprerë dhe të sigurtë.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë një zinxhir logjistik të shpejtë, të ketë të gjitha lejet e transportit (ADR) për material të rrezikshme, dhe shërbim të plotë të mirëmbajtjes së paisjeve.

Koha e furnizimit.

- Dorëzim brenda 8 deri në 48 orëve nga marrja e porosisë.
- Në raste kritike , koha e dorëzimit duhet të jetë brenda 2 deri në 4 orëve.
- Furnizimi te behet brenda orarit zyrtar te punes (brenda 8 oreve).

Furnizimi

- Operatori ekonomik njofton se ka ardhur automjeti për furnizim.
- Në prani të komisionit të pritjes së mallit dhe në prezencë të personit që përfaqëson operatorin ekonomik, bëhet peshimi i bombulave ose Tankerit, kalkulimi i njësisë matëse sipas porosisë.
- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik transporton bombulat ose tankerin me ashensor nga pika e shkarkimit deri në dhomën e gazrave në katin e 3 në Q.R.M.A të S.U.O.GJ “Koço Gliozheni”, Tiranë. Merr bombulat boshe sipas porosisë.
- Dorëzohet flete-analiza e gazrave e cila duhet të jetë me afat vlefshmërie jo më shumë se 3-6 muaj, si dhe dorëzon një kopje të faturës së shoqërimit të mallit.
- Përfaqësuesi i operatorit ekonomik firmos në proces-verbalin e pritjes së mallit, si dhe merr të firmosur të kopje të faturës së shoqërimit të mallit.
- Në rastin kur sasia e gazrave të sjella, pas peshimit dhe kalkulimit nuk korospondon me sasinë reale shënohet në proces verbal sasia reale dhe bëhet ndryshimi në faturën e shoqërimit.

3. Specifikimet për enët nën presion.

- Operatori ekonomik mbulon kostot e inspektimit vjetor të rezervuareve (Tankerit/ Bombulave), valvulave dhe sistemit të tubacionit sipas Ligjit nr.32/2016 datë 24.03.2016 “ Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.
- Të gjitha bombulat dhe tankeri duhet të jenë të çertifikuara, kolauduara dhe të disponojë dokumentacion që tregon afatin e fundit të kolaudimit. Sipas specifikave bombulat duhet të testohen (cdo 6 - 12 muaj).
- Të gjitha pajisjet duhet të jenë të pajisura me valvola sigurie dhe mbrojtëse.
- Cdo bombul duhet të ketë një etikete me ngjyre e cila duhet të korospondojë me gazin e kërkuar.
- Cdo bombul duhet të ketë një etikete me të gjitha karakteristikat e gazit, peshën bosh të bombules dhe sasinë që mbart bombula.
- Cdo bombul duhet të ketë kapucin e sigurisë.
- Për cdo furnizim operatori duhet të sjellë guarnicione të reduktorëve të gazit.
- Sigurimi i trajnimit (1 ditë) për stafin spitalor mbi procedurat e sigurta të ndërrimit dhe trajtimit të gazrave.

4. Komunikimi

- Komunikimi me Operatorin Ekonomik duhet të bëhet me telefon dhe me email.Nga moment i njoftimit duhet të kryejë realizimin e porosise brenda 8 - 48 orëve.

5. Siguria .

- Përdorimi i PPE (Personal Protective Equipment) të përshtatshme. Personi i cili kryen furnizimin e kërkuar duhet të jete i trajnuar për bombulat.
- Sistemi i menaxhimit spill-it për lëngje të rrezikshme. Në rast demtimi të bombulave ose Tankerit duhet të marrë masa për menaxhimin e situatës.

6. Afati.

- Afati lëvrimit të mallit sipas kërkesës dhe nevojave të Autoritetit Kontraktues.

Njësia e prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim për hedhjen e të dhënave në sistemin e prokurimit elektronik.

NJËSIA E PROKURIMIT